

## FORMULARI PËR REGJISTRIMIN E OFERTUESIT

LUTEMI PËRDORNI MAKINE SHKRIMI			
Shitja Nr. _____  (Lutemi shënoni Numrin e Shitjes lidhur me shitjen për të cilën doni të regjistroheni.)	Vetëm Për përdorim zyrtar  Numri i Ofertuesit _____ Nënshkrimi i nëpunësit: _____ Emri/Titulli _____ _____ Data: _____		
TË DHËNAT E OFERTUESIT			
Emri i individit (nëse Ofertuesi është individ):			
	(MBIEMRI)	(EMRI)	(EMRI I MESIT)
Data dhe vendi i lindjes:			
A po veproni si përfaqësues për dikë tjetër ( <b>Shih përkufizimin më poshtë</b> )? NËSE PO, citoni emrin e personit (ave) për të cilët po veproni si përfaqësues.			
<b>Shënim:</b> "Përfaqësues" do të thotë cilido që vepron direkt ose indirekt në emër të ose sipas udhëzimeve të një personi tjetër.			
Emri i kompanisë/Entitetit (nëse Ofertuesi është person juridik):			
Përfaqësuesi ose Zyrtari i Autorizuar i Kompanisë/Entitetit:			
	(MBIEMRI)	(EMRI)	(EMRI I MESIT)
Titulli/Pozita			
Pronar (ë) benefiçarë të Kompanisë/Entitetit ( <b>Shih përkufizimin e mëposhtëm</b> ).	Emri(at) dhe Adresat: -		
<b>Shënim:</b> "Pronar benefiçar" do të thotë pronari që përfiton aksione ose lloje të tjera të interesave të pronësisë në Kompani, i cili mund ti ketë aksionet ose interesin e vet të pronësisë të regjistruara në emrin e një personi tjetër (p.sh. një të afërmi, administratori, banke ose personi tjetër), dhe i cili mund ose ka të drejtë të shesë ose përndryshe të disponojë këto aksione dhe/ose interes pronësie, dhe të gëzojë çdo fitim apo të ardhura që mund të fitohen nga kompania.			

ADRESA DHE INFORMACIONI I KONTAKTIT PËR OFERTUESIN
Adresa e Rrugës:
Qyteti:
Shteti ose Krahina:
Kodi Postar:
Vendi:
Telefoni në banesë:
Telefoni i punës:
Faks:
Telefon celular:
Adresa e e-mail:

### Udhëzime për Ofertuesit

Ky Formular për Regjistrimin e Ofertuesit, i plotësuar dhe i nënshkruar, duhet të jetë **origjinal i dorëzuar në dublikatë** (d.m.th. në dy kopje të nënshkruara origjinale) dhe të shtypura me makinë dhe duhet të shoqërohet nga sa vijon: -

- Origjinali ose kopja e vërtetuar e një forme të vlefshme identifikimi të Ofertuesit me formë identifikimi me foto (p.sh. Pasaportë e vlefshme, Kartë e vlefshme identifikimi e lëshuar nga UNMIK, ose Dokumenti i vlefshëm udhëtimi i lëshuar nga UNMIK i vlefshëm). Ofertuesit që nuk janë individë p.sh. ortakëritë, kompanitë, etj duhet të paraqesin një kopje të vërtetuar të certifikatës së regjistrimit të biznesit dhe një listë të pronarëve ligjorë të entitetit ligjor dhe të individëve që kontrollojnë organizatën, me dokumentacionin mbështetës vërtetues.
- Autorizime origjinale (p.sh autorizimi i avokatit) për ndonjë përfaqësues të Ofertuesit, identifikimi i atij personi dhe adresa dhe informacioni i kontaktit të kërkuar për Ofertuesin më lart.
- Vërtetim pagese i taksës së regjistrimit të ofertuesit.

Dokumente të tipit kartë identifikimi studenti, patentë automjeti, kartë kredie me foto nuk mund të pranohen si mjete të mjaftueshme identifikimi.

Mënyra e regjistrimit të ofertuesit përcakton se si do të paraqitet informacioni i tyre në gjithë letrat e mëvonshme. Ofertuesit mund të zgjedhin vetëm një opsion në formularin e regjistrimit për të treguar nëse regjistrohen si individë apo si entitete juridike (p.sh. kompani). Pas regjistrimit nuk pranohen ndryshime.

Ofertuesi kupton dhe bie dakord për sa më poshtë:

1. çdo shitje pasurie që kryhet nga Agjencia Kosovare e Mirëbesimit (këtu e më poshtë “Agjencia”) ose nga çdo palë që vepron në emër të ose me autorizimin e Agjencisë i nënshtrohet (i) **“Rregullave të tenderit për shitje pasurie me anë të një procesi ofertimi konkurrues, të vulosur”** (këtu e më poshtë **“Rregullat e Tenderit”**) dhe (ii) kushteve të veçanta të punës për shitjen dhe/ose dispozitave të shitjes të listuara në Njoftimin për Shitje Publike dhe/ose ndonjë

dokument tjetër të ofertës siç përcaktohet në **Rregullat e Tenderit** ku përfshihet edhe ndonjë bashkëngjitje e këtyre dokumenteve. Duke plotësuar këtë formular dhe duke dorëzuar ofertën, Ofertuesi pranon tu nënshtrohet dokumenteve të përmendura më lart.

Termet që fillojnë me shkronjë të madhe kanë kuptimet që u jepen atyre sipas Rregullave të Tenderit përveç kur konteksti kërkon ndryshe.

Kopje të **Rregullave të Tenderit** mund të merren nga konkati(et) e mëposhtme, ose të tërhiqen nga faqja e internetit të AKM-së ([www.kta-kosovo.org](http://www.kta-kosovo.org)).

2. Personat juridikë dhe fizikë që futen në një nga kategoritë e mëposhtme nuk pranohen si ofertues të pranueshëm për të paraqitur ofertë dhe do të shkualifikohen automatikisht nëse ndonjë prej tyre paraqet ofertë:

- (a) Personat fizikë ose juridikë që janë aktualisht subjekt i një procedure falimentimi ose insolvency (paaftësi paguese);
- (b) Personat fizikë që janë dënuar për një vepër penale serioze e cila është kryer pas qershorit 1999 ose që përndryshe janë në ndjekje penale;
- (c) Personat fizikë dhe juridikë të cilët (i) kanë kryer shkelje materiale të kontratës së lidhur me Agjencinë ose me një ndërmarrje të administruar nga Agjencia (prania dhe materialiteti i kësaj shkeljeje duhet të përcaktohet nga Agjencia në diskrecionin e saj të vetëm) ose që kanë qenë Oferta Fituese në një shitje të mëparshme të organizuar nga Agjencia por që nuk kanë plotësuar blerjen me Agjencinë, përveç se kur Agjencia bie dakord ndryshe; (ii) kanë një detyrim të papaguar ndaj Agjencisë ose një Ndërmarrjeje të administruar nga Agjencia; (iii) janë në listën e personave ose entiteteve me të cilët Agjencia, UNMIK ose Bashkimi Evropian e ka të ndaluar, nga një entitet i njohur ndërkombëtar, si për shembull OFAC, të kryejë transaksione, duke përfshirë edhe një listë të personave që i nënshtrohen sanksioneve ndërkombëtare ose rregullave të kontrollit të eksportit; ose (iv) janë persona fizikë ose juridikë që nuk kanë paguar gjokat e vëna nga Agjencia sipas kompetencave të saj të parashtruara në nenin 27 të Rregullores së UNMIK 2002/12 ose që i nënshtrohen ndonjë kërkesë ose mosmarrëveshjeje (qoftë kur çështja është në gjykatë ose ndryshe) lidhur me nenin 28 të Rregullores 2002/12 të UNMIK sipas ndryshimeve;
- (d) Personat fizikë dhe juridikë që veprojnë si agjentë/përfaqësues për ndonjë person ose entitet të përmendur në nenet 2(a)-(c) më lart ose ndonjë agjent/përfaqësues që nuk ka zbuluar punëdhënësin e tij/të saj, sipas kërkesave të Rregullave të Tenderit; dhe
- (e) Entitetet juridike ku Pronarët Benefiçarë ose Personat e Kontrollit bëjnë pjesë në një nga kategoritë e parashikuara në nenet 2(a) – (d) më lart.

3. Me anë të bërjes së kërkesës për tu përfshirë në Regjistrin e mundshëm të Ofertuesve, Ofertuesi konfirmon dhe vërteton se ka autoritet përfaqësimi, qoftë të nënkuptuar ose të ndonjë lloji tjetër për sa vijon:

- (a) Për t'i shpalosur Agjencisë informacionin e përfshirë në këtë Formular Regjistrimi dhe se gjithë personat ose entitetet juridike të përmendura në këtë kërkesë/aplikim kanë dhënë pëlqimin lidhur me shpalosjen e informacionit, dhe
- (b) Për të dhënë çdo lloj informacioni dhe gjithë informacionin dhe dokumentacionin shtesë të kërkuar nga Agjencia (i) për të plotësuar çdo kërkesë ose procedurë lidhur me pastrimin e parave (ii) për qëllimet e ndonjë hetimi nga ana e Agjencisë për të konfirmuar origjinën e fondeve të çmimit të blerjes (iii) për qëllimet e konfirmimit nga ana e Agjencisë se Ofertuesit Fitues janë të pranueshëm sipas nenit 2.1 të Rregullave të Tenderit (d.m.th. neni 2 më lart) dhe/ose (iv) për qëllimet e përputhjes me Ligjin e Zbatueshëm ose praktikatat më të mira ndërkombëtare, sipas përcaktimit të Agjencisë.

5. Agjencia mund të vendosë një taksë minimale regjistrimi për ofertimin për të mbuluar shpenzimet të cilat do të specifikohen në Njoftimin për Shitje Publike. Në kohën e dorëzimit të dokumenteve të regjistrimit, Agjencisë duhet ti dorëzohet një çertikatë e rregullt (p.sh. kopje e fletë depozitimit) të pagesës së kësaj takse në një nga llogaritë e Agjencisë.

Pohoj se kam lexuar, kuptuar dhe bie dakord me kushtet e përmendura më lart, dhe konfirmoj se jam i pranueshëm për të paraqitur ofertë në lidhje me kërkesat e paragrafit 2, më lart.

Pranuar nga Ofertuesi:

Nënshkrimi: \_\_\_\_\_

Emri: \_\_\_\_\_

Data: \_\_\_\_\_

Vetëm për përdorim zyrtar			
<b>Nëse taksa e regjistrimit të ofertuesit është kërkuar sipas specifikimit të Njoftimit të Shitjes Publike, paraqit vërtetim pagese të kësaj takse (Shëno me kryq kutinë e duhur) <input type="checkbox"/> Po <input type="checkbox"/> Jo</b>			
IDENTIFIMI I DHËNË NGA OFERTUESI			
Lloji i Dokumentit Identifikues	Nr & Data e Lëshimit	Lëshuar nga	Skadimi
<b>Pasaportë</b>			
<b>Tjetër (specifiko):</b> _____			
IDENTIFIMI I DHËNË NGA PËRFAQËSUESI I OFERTUESIT:			
Lloji i dokumentit identifikues	Nr & Data e Lëshimit	Lëshuar nga	Skadimi
<b>Pasaportë</b>			
<b>Tjetër (specifiko):</b> _____			
AUTORIZIMI I DHËNË PËRFAQËSUESIT:			
Lloji i Dokumentit	Lëshuar nga/Data e lëshimit	Kompetencat e dhëna	Skadimi
<b>Autorizim avokati</b>		_____	

<b>Tjetër (specifiko):</b> _____			
<b>Shënime (Bashkëngjit fletë të veçanta nëse është e nevojshme):</b>			